

**MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM**  
**NDËRMJET**  
**AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT**  
**DHE**  
**KOMISIONIT PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE**  
**PUBLIKE TË LATVISË**

AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT (ARRU) DHE KOMISIONI PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE PUBLIKE TË LATVISË (PUC), (Palët), duan që të promovojnë interesat e përbashkëta për aspektet e rregullimit të menaxhimit të furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimit;

Duke marrë parasysh nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim si një kornizë për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimit të informacionit në bazë të barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të përbashkëta,

Janë pajtuar që të bashkëpunojmë si më poshtë:

**1. Shkëmbimi i informacionit**

Palët do të ndajnë informata relevante që kanë interesa të përbashkëta siç janë: politikat rregullatore në sektorin e ujit që nuk janë konfidenciale; monitorimin e performancës dhe zhvillimin e raporteve të performancës; metodologjinë e përcaktimit të tarifave dhe planeve të menaxhimit të aseteve; dhe informacione tjera relevante, me qëllim që të mundësojë stafin që të mësojnë përvojat e njëri tjetrit nga të dy institucionet.

Shkëmbimi i informacionit do të vendoset duke respektuar ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për dy shtetet kombëtare,

**2. Ndarja e njohurive**

Palët do të punojnë në ndërtimin e njohurive të tyre rreth qasjes së njëri-tjetrit në lidhje me çështjet të ndryshme rregullatore me qëllim të sigurimit të cilësisë në zbatimin e rregullimit ekonomik të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit. Kjo do të jetë në formën e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave që palët të zbatojnë punën e tyre.

**3. Ngritja e kapaciteteve — zhvillimi i stafit**

Sa here që të jetë e mundur dhe e përshtatshme palët do të mbështesin stafin e tyre :

- Pjesëmarrja në aktivitete specifike dhe projekte që organizon pala tjetër;
- Pjesëmarrja në aktivitete të trajnimit të palës tjetër;

- Pjesëmarrja në konferenca, seminare, punëtori që mund të organizojnë palët së bashku apo veç e veç,

#### 4. Bashkëpunimi në mes institucioneve

Sa here që është e mundur dhe e përshtatshme, palët do të bashkëpunojnë në sigurimin e procesit institucional dhe rregullator të procesit të funksionimit cilësor institucional dhe rregullator. Gjithashtu palët do të bashkëpunojnë në kornizën e organizimit të asociacioneve rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimi të sektorit të ujit..

#### 5. Personat përgjegjës për implementim

Drejtori i ARRU dhe kryesuesi i PUC do të jen përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Kjo përgjegjësi mund të delegohet tek anëtarët përkatës të institucioneve të tyre në fushat përkatëse të bashkëpunimit.


#### 6. Resurset

Të dyja palët do të mbulojnë shpenzimet e tyre në lidhje me bashkëpunimin sipas kësaj marrëveshje, me përjashtim të rasteve kur ne do të pajtohemi ndryshe kjo do të specifikohet në një marrëveshje specifike.

#### 7. Implementimi

Çdo çështje ose kontekst që mund të dalë nga interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunim do të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave midis palëve ose mënyrave të tjera që palët vendosin.

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi që nga data e nënshkruar nga Pala e fundit.

Nënshkruar në Prishtinë, Kosovë, më 01Nëntor 2017	Nënshkruar në Riga, Latvia, më 01Nëntor 2017
Për ARRU	Për PUC
	
Raif Preteni, Drejtor	Rolands Irklis, Kryesues